



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
Sektori i Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Nr. 34895 Prot.

Tiranë, më 4 . 11 .2016

Lënda: **Kthim përgjigje**

Drejtuar: **Z. Dorian Matlija**
Qendra "Res Publika"
Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H3, Ap 44

TIRANË

I nderuar z.Matlija,

Në cilësinë e kërkesit, keni depozituar në formë shkresore, kërkesën për informacion, datë 14.10.2016, si një përmbledhje të kërkesave tuaja nr.212/16, 213/16, 214/16 dhe 215/16 datë 13.10.2016, protokolluar në DPT nr.34895 Prot, datë 20.10.2016 si dhe regjistruar në regjistrin e kërkesave me numër rendor 4 datë 25.10.2016, bazuar në Ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", në vijim të komunikimit të mëparshëm në të cilin, në bazë të nenit 15 të Ligjit të sipërcituar është komunikuar shtyrja e afatit të marrjes së informacionit si dhe është saktësuar mënyra e përshkrimit të përgjigjeve, ju dërgojmë këtë shkresë me informacionin e kërkuar, duke shpjeguar pozicionin në faqen e internetit www.tatime.gov.al, të menuve përkatëse, si më poshtë vijon:

1. DPT administron faqen e saj të internetit www.tatime.gov.al, nëpërmjet së cilës, në zbatim të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, "Për procedurat Tatimore", i ndryshuar neni 28, informon çdo tatimpagues, por edhe publikun e gjerë, lidhur me organizimin dhe funksionimin e saj, informacion të përditësuar për legjislacionin tatimor në fuqi dhe çështje tatimore, si dhe krijon mundësinë e deklarimit të detyrimeve tatimore në mënyrë elektronike.
2. Konfigurimi aktual i faqes së internetit dhe respektimi i kërkesave të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit": menuja Rreth nesh, përmban të publikuar nënmenu E drejta për informim, dedikuar zbatimit të detyrimit të këtij Ligji, me informacionet përkatëse: Baza ligjore, Programi i transparencës, Struktura organizative, Legjislacioni tatimor, Procedurat e prokurimit, Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, Kontaktet e koordinorit për të drejtën e

informimit, Buxheti dhe plani i shpenzimeve për vitet 2014, 2015 dhe 2016 si dhe Modeli i kërkesës për kërkim informacioni/dokumentacioni. <https://www.tatime.gov.al/sq-al/us/E%20Drejta%20Per%20Informim/Pages/default.aspx>

- Shërbimet që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ofron për publikun: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/Sherbimet/Pages/default.aspx>
- Menu Legjislacioni tatimor përmban të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të përditësuara si dhe Vendimet teknike të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të detyrueshme për t'u zbatuar nga Administrata tatimore dhe tatimpaguesit. <https://www.tatime.gov.al/sq-al/Legjislacioni/Legjislacioni-Tatimor/Pages/default.aspx>
- Në dispozicion të publikut dhe tatimpaguesve, kjo faqe përmban rubrikën Kontakte, e cila përfshin kontakte e Drejtorive Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve, Drejtorive Rajonale Tatimore, numrin jeshil për denoncime si dhe adresën e e-mailit, kontaktet për mediat etj. <https://www.tatime.gov.al/sq-al/Kontakte/Pages/default.aspx>
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/E%20Drejta%20Per%20Informim/Pages/Kordinatoripertedrejteneinformimit.aspx>
- Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/Drejtoria%20e%20P%20abrgjithshme%20e%20Tatimeve/Pages/Organigrama-e-DRT.aspx>
- Struktura organizative e Drejtorive Rajonale Tatimore: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/Drejtorit%20e%20Rajonale%20Tatimore/Pages/Organigrama-e-Deg%20e%20abve-t%20e%20ab-Tatimeve.aspx>
- Administrata Tatimore është në proces ristrukturimi dhe shumë shpejt do të kemi një Rregullore të re në përputhje me strukturën e re organizative.
- Dokumentat strategjikë në të cilët përfshihen planet strategjike të punës: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/Pages/Dokumenta-Strategjik%20e%20ab.aspx>
- Buxheti dhe Planet e shpenzimeve 2014-2015-2016: <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/E%20Drejta%20Per%20Informim/Buxheti%20dhe%20Plani%20i%20shpenzimeve/Pages/default.aspx>
- Në lidhje me treguesit e performacës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, treguesit statistikorë për realizimin e mbledhjes së të ardhurave paraqiten në link : <http://www.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore>, i cili lidhet automatikisht me faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

- Raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit publikohen në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.
- Informacion mbi procedurat e prokurimit etj : <http://www.tatime.gov.al/sq-al/us/E%20Drejta%20Per%20Informim/Pages/Per-Procedurat-e-Prokurimit.aspx>
- Numri i kërkesave të depozituara pranë DPT për periudhën janar – shtator 2016 është 3 kërkesa, nga të cilat 2 janë konsideruar si të tilla në kuptim të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit dhe janë regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”. Kërkesa e tretë nuk i përmbushte kushtet e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pasi kërkuesi z.Leka Filto nuk kërkonte informacion publik të lidhur me veprimtarinë e Administratës Tatimore, por informacion lidhur me funksionimin e një grupimi të caktuar biznesesh.
Numri i kërkesave të cilat kanë marrë përgjigje është: 2, (bashkëngjitur kopje e përgjigjeve) si dhe i është kthyer përgjigje z. Leka Filto (sipërpërmendur).
Numri i kërkesave të cilave iu është refuzuar dhënia e informacionit është: 0
Në 2 kërkesat e paraqitura për periudhën Janar - Shtator 2016, kërkohet informacion në lidhje me numrin e OJF-ve të regjistruara në Administratën Tatimore.

Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është ngritur një grup pune për përmirësimin e faqes zyrtare të internetit, me qëllim për t’a bërë përmbajtjen e saj më të kuptueshme si dhe më lehtë të aksesueshme nga tatimpaguesit dhe publiku.

Për lehtësi përdorimi nga ana juaj, ky informacion do t’ju dërgohet edhe në mënyre elektronike në adresën tuaj të emailit: dorian.matlija@gmail.com

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VASILIKA VJERO